



VENDIM

Nr. 41, Datë 06.03.2017

**PËR
MOS FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E
SHOQËRISË “CGC SH.P.K NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
GAZIT NATYROR (SHITJE ME SHUMICË)**

Në mbështetje të nenit 4 pikat 50, 105, 107; nenit 22 pika 2 gërma “ç”; nenit 83 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”; neneve 4, pika 1, gërma ”ç”; 8, 9 pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, gërma ”e” dhe nenin 10, pika 1 të Rregullave dhe Procedurave për Liçensimin, Ndryshimin, Transferimin e Pjesëm ose të Plotë, Heqjen dhe Rinovimin e Liçensave në sektorin e Gazit Natyror“ miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr.9 datë 11.02.2011; nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr.96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.03.2017, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria CGC sh.p.k si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për liçensimin në aktivitetin e tregëtimit të gazit natyror të shoqërisë CGC sh.p.k.,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “CGC sh.p.k.” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e gazit natyror”, si më poshtë:

- Formatit dhe Dokumentacioni për Aplikim (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyre korrekte.
- Dokumentacioni Ligjor, Administrativ dhe Pronësor, (neni 9, pika 1, gërma “d”/i, d/ii) është plotësuar në mënyre korrekte.
- Dokumentacioni dhe Garancitë Financiare dhe Fiskale (neni 9, pika 1, gërma e/i, e/ii, e/v, e/vi), janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Rezulton dokumentacion i munguar që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 1, gërma “d”/V, d/VI, dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor.

- Nenin 9, pika 1, gërma e/iii, dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale.
- Nenin 9, pika 2, gërma e/i, e/ii, e/iii, dokumentacioni specifik për llojin e licensës.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për licensimin e shoqërisë “CGC” sh.p.k në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror. (shitje me shumicë)
2. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI